



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRI - URED PRERMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org. Org. jedinec Org. Unit	01.C	Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No:	3514
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	3	Data: Datum: Date:	09/11/2018
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Nacionalni Koordinator za Kulturu, Omladinu i Sport
National Coordinator for Culture, Youth and Sport

Datë. 09.11.2018
Nr. Prot: 067/2018

Në bazë të Nenit 12 Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport *nxjerr këtë:*

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet e organizatave jo-qeveritare në forcimit dhe promovimit të dijes, sportit dhe kreativitetit kulturor dhe mendim kritik.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të programi 10700 të Zyrës së Kryeministrit.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin 1 do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
 1. Teksti i thirrjes publike
 2. Udhëzimet për aplikantët
 3. Formularët e aplikimit
 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 3. Forma e deklaratës së mungesës së fondeve të dyfishta
 4. Forma e deklaratës së partneritetit
 5. Forma e deklaratës së projekteve të financuara
 6. Deklaratë pranimi për kryerjen e aktiviteteve në projekt
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare www.kryeministri-ks.org.

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Rexhep Hoti

Koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport

Ju dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
- Zyrës për Buxhet dhe Financa në ZKM
- Arkivit të ZKM-së